

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi dhe Xhevdet Abazi, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Përparim Zeka, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.K. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së dhe të akuzuarit E.I. nga Gjilani, për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, PKR.nr.415/13 datë 01.11.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 23.01.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, PKR.nr.415/13 datë 01.11.2017, **vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren me aktgjykimin PKR.nr.415/13 datë 01.11.2017, të akuzuarit D.K. dhe E.I., i ka liruar nga akuza konform nenit 364 par.1 pika.1.3 të KPP-së, dhe atë secilin për veprën penale, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KP-së. E dëmtuara AKP për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil. Shpenzimet e procedurës, bien në barrë të mjeteve buxhetore kësaj Gjykate.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

- Prokuroria Themelore në Prizren, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimin mbi sanksionin penal, duke propozuar që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore prish dhe të njëjtën ta kthej në rigjykim ose ta ndryshoj në atë mënyrë që të akuzuarit D.K. dhe E.I., secilin veç e veç për veprën penale, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KP-së ti shpallë fajtorë dhe t'iu shqiptoj dënimet në kufi të minimumit dhe maksimumit të lejuar ligjor, si dhe ne kuptim të dispozitës së nenit 62 par.2.4 të KP-së të akuzuarve tu shqiptoj dënim plotësues ndalim i ushtrimit të detyrës, për kohëzgjatjen e së cilës duhet të vendos Gjykata.

-Përgjigje të përbashkët në ankesën e PTH kanë parashtruar mbrojtësit e të akuzuarit D.K., av. H.P. dhe av. H.S. me të cilën në tërësi i kundërshtojnë si ligjërish të pa qëndrueshme bazat ankimore të prokurorisë. Gjithashtu kërkojnë që të lajmërohet i akuzuari dhe mbrojtja për seancën e kolegjit në Gjykatë.

-Përgjigje në ankesën e PTH ka parashtruar i akuzuari E.I. me propozim që të refuzohet si e pabazuar ankesa e PTH, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA./I.nr.545/17 datë 28.12.2017, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Themelor në Prizren të aprovohet si e bazuar, kurse përgjigja në ankesën e prokurorit të PTH e parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit D.K., av. H.P. dhe av. H.S. dhe ajo e parashtruar nga i akuzuari E.I. të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e kësaj lënde, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore konstatoi:

-ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren nuk është e bazuar.

Prokuroria në ankesë thekson se aktgjykimi ankimuar është në kundërshtim, pra përmban shkelje nga të gjitha bazat nga neni 383 par.1 i KPP-së, prandaj si e tillë nuk mund të ekzaminohet në mënyrë të ligjshme. Dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është kundërtë me arsyet si dhe provat tjera të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe nuk ka arsye të duhura lidhur me faktet relevante të kësaj çështje penale. Prokuroria mendon se konkludimi i Gjykatës së shkallës së parë që të akuzuarit të lirohen nga akuza është i gabueshëm ngase nga provat e parashtruara nga Prokurori i Shtetit e në të cilat është bazuar aktakuza janë të mjaftueshme dhe vërtetojnë që në veprimet e të akuzuarve qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilat janë akuzuar. Konstatimi i Gjykatës se nuk ekziston asnjë provë që dëshmon se AKP-ja e ka nën administrim “Jugobankë”-n si ndërmarrje shoqërore dhe se i akuzuari i parë që ishte në pozitën e drejtorit në këtë Bankë nuk ka pranuar kurrfarë vendimi nga AKP-ja për një gjë të tillë është i gabueshëm. Gjykata nga provat materiale të administruara ka vërtetuar se në qershorin e vitit 1995 në bazë të kontratës mbi themelimin e “Jugobankës” është bërë themelimi i “Jugobankës”, “Jug Bankës” shoqëri aksionare dhe si e tillë është regjistruar në regjistrat e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë. Nga provat materiale rezulton se kontratat e shitblerjes si objekt të shitblerjes e ka pasur pronën e cila gjendet në Gjilan, në rrugën “Marshall Tito”, Gjilan gjendet në Kosovë dhe i nënshtrohet ligjeve që veprojnë në Kosovë. Është vërtetuar se i akuzuari i dytë E.I. ka qenë referent përgjegjës për vërtetimin e kontratave, me provat materiale, kërkesën për informatë e mbështetur nga deklaratat e dëshmitarit Xh.S. është vërtetuar se kërkesa për informatë është pranuar në Gjykatën e Gjilanit nga kjo periudhë që i akuzuari E.I. duke ditur për ndalesën dhe kërkesën e AKP-së legalizon një kontratë të cilën nuk ka guxuar ta legalizoj. Gjykata gabimisht ka konstatuar se në rastin konkret nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit të parë dhe të akuzuarit të dytë nuk janë formuar elementet esenciale të veprave penale për të cilat janë liruar nga akuza. Në këtë rast Gjykata e shkallës së parë në tërësi ka krijuar bindje të gabueshme dhe nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe gabimisht i ka besuar fakteve dhe të njëjtat i ka konsideruar si prova shfajësuese e në realitet provat të cilat janë përmendur dhe elaboruar janë prova fajësuese. Prokuroria konstaton se sikur Gjykata e shkallës së parë ti vlerësonte në mënyrë të drejtë provat dhe rrethanat e lartpërmendura, të akuzuarit do ti shpallte fajtorë dhe do tu shqiptonte dënimet e parapara me dispozita ligjore.

Gjykata e Apelit e Kosovës me vëmendje e ka shqyrtuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren, aktgjykimin e atakuar dhe shkresat e lëndës dhe vlerësoi se ankesa është e pa bazuar. Aktgjykimi është i qartë dhe konkret, gjykata ka dhënë arsyet për faktet vendimtare, ka arsyetuar provat dhe në rastin konkret drejtë ka vepruar kur ka konsideruar se nuk ka prova të cilat e mbështesin dyshimin e bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale e cila iu është vënë në barrë në bazë të aktakuzës së Prokurorisë. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike duke analizuar dhe arsyetuar të gjitha provat materiale dhe jo materiale, duke i ndërlidhur njëra me tjetrën dhe duke ardhë deri tek një gjendje faktike ku nuk vërtetohet fajësia e të akuzuarve. Kjo gjykatë në përgjithësi

pajtohet me të gjeturat dhe konstatimet e gjykatës së shkallës së parë përveç asaj pjese të arsyetimit ku gjykata e elaboron Ligjin për Bankat, Institucionet financiare dhe Institucionet financiare jo Bankare nr. 04/L-093 e që ka të bëj me bankat si shoqëri aksionare pasi që vlerësimi i gjykatës se bankat nuk kanë statusin e ndërmarrjes shoqërore dhe si të tilla nuk mund të jenë nën administrimin e AKP, nuk është i drejtë, për faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me institucione apo ndërmarrje të themeluara para luftës gjegjësisht para vitit 1999, e që si e tillë hyn edhe Jugobanka. Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se në rastin konkret a ka pasur dashje për ta kryer veprën penale e cila ishte vënë në barrë të akuzuarve, gjegjësisht a ishin të njoftuar të akuzuarit për një vendim të AKP me të cilin Jugobanka trajtohet si ndërmarrje shoqërore dhe se ekziston ndalesa për shitjen e së njëjtës. Nëse marrim parasysh se dispozitën ligjore të nenit 422 par.1 të KPRK-së, parashihet se „ *Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër*” . Për qëllime të këtij neni, shpërdorimi i detyrës zyrtare përfshinë, por nuk kufizohet në: 2.1. *shkeljen me dashje apo me dijeni të ligjit lidhur me detyrat apo punësimin e zyrtarit*; 2.2. *moskryerja me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj*; 2.3. *pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë së çfarëdo lloji si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare, përveç nëse pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë lejohet me ligj*; 2.4. *keqpërdorimi i pasurisë, shërbimeve apo personelit qeveritar apo i ndonjë sendit tjetër me vlerë që i përket qeverisë e që ka rënë në kujdesin apo posedimin e zyrtarit si rezultat i detyrës apo punës së tij*; 2.5. *nënshtrimi me dashje i personit tjetër në keqtrajtim ose arrest, ndalim, kontroll, marrje, heqje, vlerësim ose barrë për të cilën e di se është e kundërligjshme; ose 2.6. ndalimi ose pengimi me dashje i tjetrit në ushtrimin apo gëzimin e ndonjë të drejte, privilegji, pushteti apo imuniteti ligjor*. Pra në këtë rast veprimi i kryerjes është përcaktuar në mënyrë alternative dhe vepra penale paraqitet në tri forma, që janë: *shfrytëzimi i pozitës zyrtare (shpërdorim) apo autorizimeve, tejkalimi i autorizimeve zyrtare dhe mos përmbushja e detyrave zyrtare (moskryerja e detyrimeve zyrtare)*. Nga provat e administruara është vërtetuar se i akuzuari i parë në bazë të vendimit të Bordit të Jugobankës, ka nënshkruar kontratën mbi shitblerjen të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjilan me datë 12.11.2010 me blerësin R.H. për shitjen e objektit afarist të Jugobankës në Gjilan. Kjo fare nuk është kontestuese por kontestues mbetet fakti se a i ka tejkualuar autorizimet e veta me qëllim që tjetrit të i shkaktoj dëm. Nga provat e administruara është vërtetuar se i njëjti si kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Jugobankës Sh.a në bazë të autorizimeve të dhëna e ka nënshkru kontratën mbi shitblerjen e cila është legalizuar pranë Gjykatës Komunale në Gjilan nga referenti tani i akuzuari E.I. Nga provat e administruara gjegjësisht nga dëshmitari Xh.S. është theksuar se AKP me vendim ka përcaktuar se Jugobanka e ka statusin e ndërmarrjes shoqërore dhe me këtë vendim ka njoftuar të gjitha organet relevante, por siç e thekson edhe gjykata e shkallës së parë akuzat ka dështuar që gjykatës tia parashtrij këtë vendim me të cilin vërtetohet një gjë e tillë si dhe faktin se i akuzuari i parë në mbrojtjen e tij ka theksuar se nuk ka par kurrfarë vendimi të tillë nga Bordi i AKP. Sa i përket të akuzuarit të dytë, nuk është vërtetuar se i njëjti me dashje ka shkelur ligjin lidhur me detyrat zyrtare duke i shkaktuar dëm personit tjetër duke e legalizuar kontratën mbi shitblerje ku sipas prokurorisë i njëjti ka qenë i njoftuar me datën 05.01.2010 nga AKP-ja me “kërkesë për informatë” që mos të bëj legalizimin e asnjë kontrate të shitblerjes pa pëlqimin paraprak të AKP. Kjo nuk ka mundur të vërtetohet pasi që edhe vetë dëshmitari Xh.S. ka deklaruar se këtë kërkesë për informatë ia ka dorëzuar referentit civil e jo zyrës së pranimit ashtu siç është dashur. Se nga regjistri për pranim-dorëzim të postës askund nuk është regjistruar shkresa e AKP, 0001/2010 e datës 05.01.2010 mirëpo është regjistrua një shkresë tjetër e AKP me numër 0009/2010 e cila nuk ka të bëj fare me këtë kërkesë për informatë. I akuzuari duke mos pasur një ndalesë zyrtare nga AKP, ka vërtetuar kontratën në fjalë duke bërë identifikimin e personit dhe duke vërtetuar

nënshkrimet e palëve kontraktuese duke vepruar në suaza të detyrave të tij të punës. Kjo vërtetohet edhe nga vetë dëshmitari M.A. i cili në atë kohë ka qenë në cilësinë e UD kryetarit të gjykatës e i cili deklaroi se nuk ka pranuar asnjë shkresë apo ndalesë lidhur me paluajtshme rinë kontestuese dhe se për me ekzistua ndalesa është dashur që gjyqtari të merr aktvendim për mbi caktimin e masës së përkohshme për ta ndaluar qarkullimin e një prone të caktuar e cila pastaj do ti ekspedohej zyrës për legalizimin e kontratave e në rastin konkret nuk ka pasur ndonjë vëndim të tillë. Prandaj bazuar në provat e administruara e të vlerësuara më lartë me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka marrë aktgjykim lirues për të dy të akuzuarit në mungesë të provave.

Duke pasur parasysh se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë nuk kemi as shkelje të ligjit penal e që do ta kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.581/17, më 23.01.2018

Procesmbajtësi,
Përparim Zeka _____

Kryetare e kolegjit – gjyqtarja,
1. Mejreme Memaj _____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi _____

3. Xhevdet Abazi _____